

Allahu nuk udhëzon keqbërësit

Shejh Abdu-Rrahmaan es-Sa'di, *Mewaahib er-Rabbaanijeh*, f.84-85

Sikur të thuhej: Allahu ﷻ na informoi në më shumë se një vend se nuk do të udhëzojë as njerëzit keqbërës, as ata që tejkalojnë të gjithë kufijtë, as popullin mosbesues, as kriminelët; mirëpo, shohim sesi Ai ka udhëzuar shumë njerëz keqbërës, shkelës kufijsh, mosbesimtarë e kriminelë. Megjithëkëtë, thuhet se fjala e Allahut është e vërtetë dhe e saktë dhe nuk bie ndesh asnjëherë me realitetin (Pra, si qëndron puna?).

Përgjigjja do të ishte: Allahu ﷻ na tha se nuk i udhëzon ata që meritojnë ndëshkimin dhe dëshpërimin e përhershëm. Atëherë, kur kjo të meritohet, shkaqet për këtë zënë vend, vendosen mirë dhe ndodhin pashmangshëm. Në këtë rast, s'mund të ketë kurrfarë ndryshimi. Allahu ﷻ tha:

“Kështu u zbatua me të drejtë fjala e Allahut për ata që nuk besuan - ata janë banorë të Zjarrit.” (40:6)

“Dhe vërtet që fjala e Allahut u zbatua me të drejtë kundra atyre që ngulmuan në mosbindje – ata nuk do të besojnë.” (10:33)

“Vërtet, ata kundër të cilëve u zbatua me të drejtë fjala e Allahut, nuk do të besojnë, edhe sikur t'u vijë çdo shenjë (argument), derisa të shohin ndëshkimin e dhembshëm.” (10:96-97)

Për këta njerëz urtësia e Allahut kërkon që Ai të mos i udhëzojë, për shkak se nuk meritojnë udhëzimin dhe s'janë të përshtatshëm për të.

“Sikur Allahu të dinte për ndonjë të mirë në ta, Ai do t'i bënte të dëgjonin patjetër. Dhe po t'i bënte të dëgjonin, ata do t'ia kthenin shpinën (të vërtetës).” (8:23)

Këta janë njerëzit që jepen pas shkaqeve që sjellin dëshpërimin e përhershëm dhe janë të kënaqur me to, duke zgjedhur kështu gjëra të këtilla në vend të udhëzimit.

Për sa u përket atyre që u priu e mbara nga Allahu ﷻ, Ai i udhëzon ata, pavarësisht nga ajo çfarë bëjnë. Allahu ﷻ udhëzoi shumë udhëheqës të mosbesimit, të cilët më herët kishin luftuar kundër Tij, kundër të Dërguarit të Tij dhe kundër Librit të Tij. Dhe Allahu është i Gjithëdijsmi, i Urti.

Kështu, ata për të cilët Allahu ﷻ na informoi se nuk i udhëzon, janë ata që meritojnë dëshpërimin e përhershëm, ndërsa ata që Ai i udhëzon, janë ata për të cilët Ai bëri t'u prijë e mbara. Me fjalë të tjera, privimi nga udhëzimi vlen për një kategori njerëzish, ndërsa dhënia e udhëzimit vlen për një kategori tjetër. Pra, s'ka kundërthënie, kështu që Allahu është i denjë për çdo lavdërim. (*Mewaahib er-Rabbaanijeh*, f.50-51)

Më pas, në të njëjtin punim Imam es-Sa'di vazhdon duke thënë:

Dobi: Kjo në fakt është një shtojcë për pikën e mësipërme lidhur me njoftimin që na bën Allahu ﷻ për atë se nuk udhëzon keqbërësit, mosbesuesit, etj, pavarësisht se Ai u jep udhëzim disa prej atyre që hyjnë në këto përshtime. Përgjigjja në këtë - që u përmend më lart - ishte se udhëzimi u mohohet atyre për të cilët Ai caktoi të jenë gjynahqarë kriminelë nga banorët e Zjarrit, kurse udhëzimi u ndodh atyre që s'janë të këtillë.

Tash, një gjë mu bë e qartë. Ky ishte një kuptim që nuk pushonte së më hutuari, derisa ma sqaroi Allahu ﷻ. Dhe Allahut i takon tërë lavdërimi! Kjo është zgjidhja e këtij ajeti fisnik:

“Kur ndëshkimi të bëhet i detyrueshëm, Ne do të nxjerrim nga toka një bishë e cila do t'u flasë, sepse njerëzit nuk qenë të bindur në Shenjat Tona.” (27:82)

Ky ajet konfirmoni ajetin paraprak:

“Vërtet që ti s'mund të bësh as të vdekurit e as të shurdhët të dëgjojnë, kur ata kthejnë shpinën dhe tërhiqen. Dhe ti s'mund të udhëzosh të verbrit që të shohin devijimin e tyre. Ti s'mund të bësh të dëgjojë askënd tjetër përveç atyre që besojnë në ajetet Tona dhe dorëzohen (vullnetit Tonë).” (27:80-81)

Allahu ﷻ ia tha këtë të Dërguarit të Tij si një formë ngushëllimi për mosbesimin që i vinte nga ana e mosbesimtarëve kryeneçë dhe kjo nuk dëmton të vërtetën aspak.

Kështu, Allahu ﷻ ia bëri të qartë të Dërguarit të Tij se përpjekjet e tij për të udhëzuar të paudhët s'do t'u bëjnë dobi atyre. Ata që dëgjojnë me pranim e bindje dhe kanë dobi janë vetëm:

“... ata që besojnë në ajetet Tona – këta janë të dorëzuarit (ndaj vullnetit të Allahut).” (27:81)

Për sa u përket atyre zemrat e të cilave s'kanë aq jetë sa për të kërkuar të vërtetën, atëherë ashtu siç nuk do të dëgjohej zëri yt nga ata që kanë vdekur fizikisht, ashtu zëri yt që thërret për udhëzim s'do të dëgjohej nga ata që kanë zemra të vdekura, as nga ata që tregohen të shurdhër ndaj të vërtetës dhe e refuzojnë, e as nga ata që cilësohen me verbëri dhe devijim. Të këtillëve Allahu ﷻ ua ka vulosur zemrat, dëgjimin dhe të parët; të këtillët janë të shkujdesurit, meritorë për ndëshkim.

Kështu, pasi të përliqet ndëshkimi për të dëshpëruarit e përhershëm, ata s'do të kenë kurrfarë dobie nga ajetet që dëgjojnë, të cilat shërbejnë si kujtim, e as nuk do të kenë dobi nga Shenjat që nuk lënë opsion tjetër përveç besimit, domethënë shenjat e mëdha që do të vijnë si pararendëse të Ditës së Kijametit. Kur Dielli të lindë në perëndim:

“... asnjë shpirti (njeriu) që s'ka besuar më herët ose s'ka përfituar nga besimi nuk do t'i bëjë dobi besimi atëherë.” (6:158)

Kur kjo të ndodhë, do të zbatohet vendimi i Allahut ﷻ që ky lloj njerëzish të mbeten në atë gjendje të mjerë. Më pas, atyre do t'u vijë një bishë e dalë nga toka, e cila do t'u flasë dhe do të vendosë dallimin mes muslimanit dhe mosbesimtarit. Kur të zbatohet vendimi i Allahut ﷻ, nuk do të ketë ndonjë ndryshim ose modifikim, kështu që e gjithë shpresa e mosbesimtarëve për t'iu kthyer besimit të vërtetë do të shuhet, edhe pasi të ndodhin shenjat më të mëdha.

Pra, ky ajet (27:82) konfirmon ajetin që i parapriu (27:80-81) dhe ofron një shpjegim të këtyre sjelljeve, domethënë për atë se, edhe sikur atyre (ata që meritojnë të ndëshkohen) t'u tregohej çdo shenjë, nuk do të besojnë derisa të shohin ndëshkimin (10:96-97). Dhe Allahu e di më së miri. (*Mewaahib er-Rabbaaniyeh*, f.84-85)